



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi dhe nenit 23 paragrafi 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, numër 12/2019), nenit 36 paragrafi 1, nenin 40 dhe neni 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), duke vepruar për denoncimin për korrupsion nga parashtues i i panjohur, në vazhdimin e seancës së 46-të të mbajtur me datë 19 shkurt 2021 morri

VENDIM

Procedura e ngritur pas denoncimit për korrupsion nr. 12-3254/1 me datë 22.06.2019 dorëzuar nga parashtues i panjohur, grup qytetarësh nga, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka bazë për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndën me numër 12-3254 nga viti 2019 e formuar ças denoncimit nr. 12-3254/1 me datë 22.06.2019.

Lënda me dumër 12-3254 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin, në formë të formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-3254 nga viti 2019 është formuar në bazë të denoncimit nr. 12-3254/1 me datë 22.06.2019, dorëzuar nga parashtues i panjohur – grup qytetarësh nga

Me akuzat në denoncim flitet për dyshime për keqpërdorime të pozitë zyrtare dhe autorizimit në fushën e urbanizmit dhe ndërtimit në teritorin e komunës, rruga – komuna kadastrale

Gjatë veprimit pët rastin e denoncuar të lëndës Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke u nisur nga akuzat e parashtuesve, me qëllim të përcaktimit të gjendjes faktike bëri kontrollime adekuate administrative në lidhje me besueshmërinë e tyre dhe bazën në mënyrë që ndërmerr veprime procesive – dorëzim të kërkesës për dorëzim të të dhënave dhe informacioneve – me shtojcë dokumentacion nga Agjensioni për kadastrë të patundshmërive, nga Inspektorati shtetëror i ndërtimtarisë dhe urbanizmit, nga komuna – inspektor i autorizuar i ndërtimtarisë të komunës, si dhe nga Njësia për revizion të brendshëm pranë komunës

Rrjedhimisht, nga organet e thirrura – shërbimet, deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit janë dorëzuar përgjigjet me shkrim me shtojcë dokumentacion i plotë.

Inspektorati shtetëror i ndërtimtarisë dhe urbanizmit me përgjigje me shkrim e informoi Komisionin shtetëror se tek ky organ është pranur ankesë nga një grup qytetarësh banorë të, në lidhje me ndërtimin e lëndës dhe të njëjtë e kanë bartur deri tek Kryetari i

komunës me çka ka pasuar veprim nga Inspektori i autorizuar i komunës për të cilën është përpiluar procesverbal për ndëgjim të palëve dhe procesverbal për konstatim të cilët datojn nga muaji korrik i viti, me të cilët akte është vërtetuar se objekti i lëndës në inspektimin mbykqyrës në momentin po realizohet në përpjuthje me miratimin për ndërtim nr.

Inspektori i autorizuar i ndërtimtarisë në komunën duke vepruar me kërkesën e Komisionit shtetëror dorëzoi përgjigje me shkrim e cila është në kontekst të inspektimit të bërë nga ana e IAN për të cilën është përgaditur procesverbal për konstatimin për vërtetimin e gjendjes faktike nr., në të cilin gjendet konstatimet sipas të cilëve dimensionet e mëdha të karabinasë së ndërtuar nuk kanë tejkalim dhe ndërtimi është në përpjuthje me projektin themelor të miratuar nga ana e investitorit – pesë persona fizik dhe një person juridik, nuk janë konstatuar uzurpime të tokës ndërtimore në pronësi të RMV duke pasë parasyshë atë që parcelat kadastrale të cilat e formojnë parcelën kadastrale të lëndës me sipërfaqe prej metra katrorë janë në pronësi të investitorit, si dhe nuk ndërtohet dhe nuk ka objekt të ndërtuar në parcelën kadastrale të përmendur KK ku si pronar i flet-pronësisë është RMV.

Deri tek Komisioni shtetëro është dorëzuar Raport final nga revizion ad-hok i bërë për ligjësinë në procesin e lëshimit të miratimit për ndërtim dhe tjetërsimit të tokës ndërtimore për rastin konkret me çka periudha kohore e revizionit është nga deri në Nga dokumenatacioni i plotë për procedurën e tjetërsimit të pronës shtetërore Njësia për revizion të brendshëm ka konstatuar se kërkesa nr. është parashtruar nga kërkusit dhe të tjerë deri tek Sekretari për urbanizëm në komunën, si dhe e njëjta i përmbanë të gjitha dokumentacionet e nevojshme në përpjuthje me ligjin për toka ndërtimore. Në procedurën e kërkesës së përmendur, me është miratur vendim për tjetërsim të tokës ndërtimore nr. dhe është nënshkruar kontratë për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të RMV me marrëveshje pa ndërmjetësues, për të cilën OVR ka specifikuar se cilat sipërfaqe të tokës dhe me çfarë çmimi janë tjetërsuar, siç është përmendur në raportin e dorëzuar, si dhe shuma e përgjithshme nga shitja në vlerë prej 1.708.000,00 denarë. Në pjesën e raportit që ka të bëjë me procedurën për marrjen e lejes për ndërtim është konstatuar se në të dy fazat nga e njëjta pas kërkesës së parashtruar për leje për ndërtim deri në dhënjën e miratimit për ndërtim të njëjtt janë në përpjuthje me dispozitat e Ligjit për ndërtim, me shënim se procedura pas parashtrimit të dytë të kërkesës për fazën e dytë ende është në rrjedhë. Nga revizioni i brendshëm, gjithashtu udhëzojnë në mendimi autentik dhe dokumenti zyrtar në lidhje me tjetërsimin e tokës ndërtimore dhe leja për ndërtim janë siguruar nga ana e shërbimeve inspektive të komunës me procesverbal të veçantë me vështirim në vend-ngjarje, ku nuk janë konstatuar parregullsi, si nga aspekti i procedurës administartive, ashtu edhe në procesi i ndërtimit në teren në vend-ngjarje.

Në të bazë të të gjitha rrethanave në rastin e lëndës së denoncuar dhe pas analizimit të plotë të gjitha dokumenatcioneve në disponim dhe shkrimeve – Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vlerëson se akuzat nga denoncimi nuk janë vërtetuar dhe se të gjitha veprimet e ndërmarra nga personat zyrtar nga komuna e të cilët kanë vepruar në rastin konkret, nuk sugjerojnë në korrupsion – keqpërdorim të funksionit, autorizimit publik, detyrës zyrtare ose pozitës për realizimin e interesave, drejtpërdrejt ose me ndërmjetësues, për

vete ose për tjetër, të cilat mund të çojn në dyshim për vepra penale të kryera nga Kreu i tridhjetë - Vepra penale kundër pozitës zyrtare nga Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe/ose me dyshim për ngritje të procedurës për vërtetim të përgjegjësisë së personave zyrtar në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interave.

Duke pasë parasysh të theksuarën më sipër, Komision shtetëror për parandalim të korrupsionit, vendosi sipas dispozitave të këtij vendimi.

Ky vendim është i prerë dhe kundër këtij nuk është e lejuar aneksa.

Vendimi është miratuar me datë 19 shkurt 2021 me numër /

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ
Kryetarë: Biljana Ivanovska**

Pas përfundimit të KSHPK
Përpunoi: H. M., këshilltarë
Miratoi: S. P. D., anëtar i KSHPK
Dorëzuar deri tek: Arkiva

